

## Kushtet e Pergjithshme te Sigurimit KASKO

Në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve Shoqëria e Sigurimeve do të dëmshpërblejë për dëmet e ndodhura në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale, në mjetin motorik në përputhje me parashikimet e bëra në Policën e Sigurimit, kushtet e mëposhtme, brenda periudhës së sigurimit dhe në territorin e përcaktuar në Policë.

### Neni 1 PËRKUFIZIME

- 1.1 **“Siguruesi”** nënkupton Shoqërinë e Sigurimeve Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sha.
- 1.2 **“I Siguruari”** nënkupton Individin, personin fizik ose juridik, mjeti motorik i të cilit sigurohet sipas kësaj Kontrate Sigurimi.
- 1.3 **“Përfituesi”** nënkupton personin fizik apo juridik i përcaktuar në Policën e Sigurimit si përfitues i vlerës së dëmshpërblimit në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.
- 1.4 **“Përfaqësuesi”** nënkupton personin fizik ose juridik, i autorizuar nga pronari i mjetit motorik, me prokurë për lidhjen dhe nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe për çdo veprim tjetër të autorizuar shprehimisht në prokurë.
- 1.5 **“Kontrata e Sigurimit”** është marrëveshja e bërë midis Siguruesit dhe të Siguruarit që përfshin kushtet e pergjithshme te percaktuara ne vijim dhe Policen e Sigurimit Kasko.
- 1.6 **“Mjet motorrik”** quhet mjeti që lëviz në tokë, por jo mbi shina, me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave. Mjetet motorrike do të quhen edhe rimorkiot ose gjysëm rimorkiot, pavarësisht nëse janë të bashkuara apo jo me mjetin motorik tërheqës.
- 1.7 **“Përdorues”** nënkupton zotëruesin e mjetit motorik dhe personat e autorizuar nga ai me kusht që të jenë shënuar detyrimisht në kontratën e sigurimit.
- 1.8 **“Mbulim”**, nënkupton rreziqet e sigurimit të cilët i referohen ngjarjeve me vërtetimin e të cilave Siguruesi përmbush detyrimin e marrë përsipër nga kjo kontratë sigurimi.
- 1.9 **“Kushtet e Sigurimit”** nënkuptojnë kushtet e Kontrates së Sigurimit, të pranuar nga Siguruesi dhe i Siguruari.

### Neni 2 OBJEKTI I SIGURIMIT

Objekti i sigurimit sipas këtyre kushteve janë mjetet motorrike, të cilat klasifikohen si të tillë sipas pikës 1.6. Dëmet që mund të pësojnë këto mjete motorrike, paraqiten në mënyrë shpjeguese si më poshtë:

- 2.1 Humbjen e mjetit motorrik;
- 2.2 dëmin total të mjetit motorrik;
- 2.3 dëme të pjesëshme të mjetit motorrik;
- 2.4 dëme në aksesorët e ndryshëm nëse përshkruhen në kërkesën për sigurim dhe përcaktuar në policën e sigurimit.

### Neni 3 RREZIQET E SIGURIMIT

Siguruesi është i detyruar të kompensojë vetëm humbjet apo dëmet e shkaktuara në mjetin motorik të siguruar, sipas Nenit 2 të këtyre kushteve, të shkaktuara prej rreziqeve të mëposhtme.

#### 3.1 Dëmtimi aksidental, si pasojë e përplasjes, përmbysjes, daljes jashtë rruge

Siguruesi do të mbulojë të gjitha dëmet që i vijnë mjetit motorik si pasojë:

- e përplasjes së mjetit të siguruar me mjete të tjera motorrike, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 14.4

- përplasjes aksidentale të mjetit motorik me një objekt fiks ose të lëvizshëm; përmbysjes aksidentale të mjetit motorik e cila rezulton brenda rruge apo përmbysje me dalje jashte rruge; dalja aksidentale jashtë rruge, përveç rastit kur keto ngjarje ndodhin për shkak se mjeti i siguruar lëviz me shpejtësi më të madhe se 20 km/orë mbi normën e lejuar.

**Nuk mbulohen si rezultat i këtij rreziku:**

- Demet ne mjetin motorrik te siguruar, si rezultat i konsumit normal, defekteve apo avarive te brendshme elektrike apo mekanike te mjetit
- Demet ne mjetin motorrik te siguruar, nga persona te paidentifikuar dhe shkaqe të paidentifikuara nga i siguruari dhe ose organet shtetërore përkatëse

**3.2 Thyerja e xhamave,**

Me termin “thyerja e xhamave” do te kuptohet që nga plasaritja deri tek thërmimi i xhamave të qartë, transparente, me përbërje të fortë plastike të përparme, të pasëm, apo anësorë të përfshirë në katalogun e prodhimit, si rezultat i veprimeve të jashtme aksidentale me ose pa dëmtimin e vetë mjetit motorik të siguruar.

Janë të mbuluara nga ky rrezik zëvendësimi i xhamave të përparme, të pasëm, anësorë si dhe te siperm të cilët mund të jenë thyer si dhe çdo gërvishtje të shkaktuar nga thyerja e xhamave.

Paguhen gjithashtu shpenzimet e transportit te personave te demtuar nga thyerja e xhamave dhe që ndodhen në mjet, deri në qendren spitalore me te afert.

**Nuk mbulohen si rezultat i këtij rreziku:**

- Dëmet në mbulesat ose perdet mbrojtëse nga dielli.
- Dëmet në xhamat të cilët nuk janë të përfshirë në katalogun e prodhimit por janë të vendosura nga i siguruari.

**3.3 Zjarri, eksplozioni dhe rrufeja**

Janë të mbuluara dëmet nga **Zjarri dhe Eksplozioni** të cilët shkaktohen nga faktorë të jashtëm, te paqellimshem dhe qe përfshijnë mjetin e siguruar.

**-Rrufeja, kur ajo bie direkt mbi mjetin motorrik**

**Nuk mbulohen si rezultat i këtij rreziku:**

- Zjarri që shkaktohet nga shkaqe të brendshme teknike të mjetit motorrik, si dhe nga veprime apo mosveprime te drejtuesit apo pasagjerëve të mjetit motorik qoftë dhe nga pakujdesia. Gjithashtu nuk mbulohen dëmet nga zjarri dhe eksplozioni si pasojë e veprimeve keqdashëse të personave të tretë, përveç kur mbulimi i pikes 3.8 është zgjedhur në mënyre specifike nga i Siguruari.
- Dëmet që shkaktohen nga pirja e duhanit në mjetin motorrik.
- Dëmet të cilat nuk janë deklaruar në strukturat e policisë dhe në repartet e zjarrëfikësit, zyrat e trajtimit të dëmeve të Siguruesit, apo janë deklaruar jashtë afateve kontraktore.

**3.4 Katastrofat natyrore**

Janë të mbuluara dëmet që shkaktohen nga katastrofat natyrore të mëposhtme:

**3.4.1 Stuhia** e cila nënkupton ç’rregullimin atmosferik me një lëvizje ajri me shpejtësi jo më të vogël se 17.2m/s ose 62 km/orë e cila mund të shoqërohet me shira, dëborë ose reshje të tjera;

**3.4.2 Breshëri** i cili nënkupton rreshje që formohen nga pikat e shiut të ngrira si akull në ajër dhe që bien kokrra – kokrra.

**3.4.3 Tufani** i cili nënkupton erën e vrullshme zakonisht me shi të madh, breshër a dëborë të dendur.

**3.4.4 Përmbytja** nënkupton daljen e ujit nga kufijtë normal të rrjedhjeve natyrale apo artificiale, të liqeneve, rezervuarëve duke kaluar bregun, ledhet, cektinat, digat, dhe shpërndahet për shkak të rrymës së ujit në nivel më të lart, si dhe vërshimi i ujit në rrugë për shkak të rreshjeve shumë të mëdha e të papritura.

**3.4.5 Vërshimi** nënkupton daljen e ujit të një lumi a përroi jashtë shtratit të tij i cili derdhet me vrull e përmbyt vendin rreth e rrotull.

**3.4.6 Dëbora** nënkupton rreshje atmosferike të ngurtë e cila bie flokë flokë nga retë në trajtë kristalesh të bardhë me formë dhe përmasa të ndryshme

Katastrofat do të mbulohen në sigurim vetëm në rastin kur janë deklaruar si të tilla nga autoritetet shtetërore. Në kuadër të katastrofave do të mbulohen sipas këtij rreziku mbulimi edhe dëmet të cilat kanë ardhur si rezultat i përmbytjes së garazhdit privat, në pronësi apo përdorim, të vetë të Siguruarit edhe në qoftë se kjo nuk ka ndodhur për shkak të përmbytjes si fenomen natyror, por për ndonjë shkak tjetër, si psh çarja e tubacioneve, me kusht që të provohet se këto të fundit nuk janë bërë me dashje.

**Nuk mbulohen në kuadër të katastrofave :**

- Dëmet dhe humbja e mjetit motorrik, të cilat shaktohen nga Tërmeti dhe Rrëshqitja e tokës, pavaresisht faktoreve që i shkaktojnë ato;
- Dëmet nga kalimi i ledheve, lumenjve, pëllgjeve ose kalimi në zonë të përmbytur me mjetin motorrik.

### **3.5 Demet e shkaktuara në parkim nga mjete të paidentifikuara dhe gjatë parkimit**

3.5.1 Me demet të shkaktuara në parkim nga mjete të paidentifikuara nënkuptohen dëmet që vijnë si rezultat i dëmtimit të mjetit motorrik, kur ai ndodhet i parkuar dhe shkaktari nuk mund të identifikohet.

3.5.2 Me dëme gjatë parkimit nënkuptohen dëmet e shkaktuara mjetit motorrik nga manovrimi i gabuar. Limiti i dëmshpërblimit sipas pikës 3.5.1. dhe 3.5.2 panvarësisht vlerës së dëmit të shkaktuar, nuk do të kalojë masë 5% te shumës së sigurimit.

**Nuk mbulohen si rezultat i këtij rreziku:**

Dëmet e shkaktuara në mjetin motorrik që vijnë si rezultat i gabimeve gjatë drejtimit të mjetit motorrik nga persona të paautorizuar gjatë parkimit.

### **3.6 Vjedhja dhe Grabitja**

Janë të mbuluara dëmet që shkaktohen nga **Vjedhja e plotë ose e pjesëshme e mjetit si dhe dëmet në tentative vjedhje.**

**Vjedhja** nënkupton çdo veprim të kundërligjshëm nga një ose disa persona me qëllim përvetësimin e mjetit motorrik të mbyllur, apo pjesëve të tij të vërtetuar nga autoritet kompetente shtetërore.

**Grabitja** nënkupton vjedhjen e kryer me forcë apo me kërcënim, me qëllim përvetësimin e mjetit motorrik të mbyllur apo pjesëve të tij të vërtetuar nga autoritet kompetente shtetërore.

**Nuk mbulohen në rastin e vjedhjes ose grabitjes:**

- Dëmet nga vjedhja të kryera nga i Siguruarit/ Përdoruesi i mjetit motorrik, punonjësit e shërbimit, punonjësit të cilët ruajnë apo mbikqyrin vendin e punës apo të parkimit.
- Dëmet nga vjedhja të shkaktuara nga mos mbyllja e dyerve, tavanëve të lëvizshme, xhamave ose në rastin kur të gjithë çelësat e makinës nuk janë në zotërim të të Siguruarit apo kur janë lënë brenda mjetit, mbi ose përreth tij.
- Dëmet nga vjedhja e pjesëshme e cila ka ndodhur nga shkaqe të pashpjegueshme pa shenja e gjurmë të dukshme dhune (vjedhje e pjesëshme).

- Dëmtimet e sistemeve dhe pajisjeve që nuk janë të nevojshëm për nisjen dhe drejtimin e mjetit, por që janë vendosur në të. Këto mbulohen vetëm kur janë pjesë funksionale e ndërtimit në bazë të mjetit motorrik me përdorim special dhe kur këto i janë njoftuar Siguruesit në momentin e marrjes në sigurim me vlerat e tyre përkatëse.

Në rastin e ndodhjes së kësaj ngjarje sigurimi, i Siguruari është i detyruar t'i dorëzojë Siguruesit të gjithë kopjet e çelësave të mjetit. I siguruari përfiton mbulim vetëm nëse humbja e çelësit është bërë përpara ndodhjes së vjedhjes të makinës, në rast të kundërt Siguruesi nuk mban përgjegjësi për ngjarjen e sigurimit.

### **3.7 Shtrirja e Sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

**Shtrirja e sigurimit jashtë** territorit të Republikës së Shqipërisë nënkupton mbulimin me sigurim për të gjitha mbulimet e zgjedhura brenda Shqipërisë, në përputhje me kushtet e Kontrates Sigurimit dhe vetëm nëse është përcaktuar me marrëveshje midis paleve.

### **3.8 Aktet Keqdashëse**

Me akte keqdashëse nënkuptohen, veprimet keqdashëse apo të qëllimshme mbi mjetin motorrik ose të drejtuara ndaj personit që drejton mjetin motorrik ose është pasagjer në të, dhe që sjellin dëmtimin e mjetit.

Me veprime apo akte keqdashëse do të kuptohet humbja, shkatërrimi ose dëmtimi i pjesshem ose i plote, shkaktuar nga zjarri, eksplozioni, dëmtimi me mjete të forta të mjetit të siguruar shkaktuar direkt ose indirekt nga veprimet keqdashëse të çdo personi ose grup personash, pa miratimin dhe/ose dijeninë e të siguruarit.

### **Nuk mbulohen si rezultat i këtij rreziku:**

Dëmet e shkatuara mjetit motorrik nga vetë i Siguruari, antarë të familjes apo personave të tjerë të udhëzuar prej tij.

### **3.9 Transporti me karotrec**

Transporti me karotrec nënkupton shërbimin e ofruar në rast të dëmtimit të rënde të mjetit motorrik që nuk lejon levizjen/qarkullimin sipas rregullave dhe nëse është përcaktuar specifikisht në policën e sigurimit.

Në këtë rast Siguruesi mbulon kostot për transportin e mjetit motorrik të dëmtuar deri në një servis, por jo më shumë se 70,000 Lekë.

## **Neni 4 PËRJASHTIMET E PËRGJITHSHME**

Përveç përjashtimeve të parashikuara më lart, nuk do të mbulohen nga Kontrata e Sigurimit humbjet dhe dëmet e shkaktuara në rastet e mëposhtme

**4.1** Nuk do të mbulohen dëmet e ndodhura në mjetin motorrik si rezultat i ngjarjeve që lidhen me:

**4.1.1** Shpërthimin bërthamor, rrezatimin bërthamor, ndotjen radioaktive, rrezatimet jonizuese, ndotjet kimike;

**4.1.2** Luftërat e çdo lloji, invazioni, luftime të tjera të armatosura pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, lufta civile;

**4.1.3** turbullirat civile, revolucionet, lëvizjet separatiste, kryengritjet popullore, rebelimet, revoltat, puçeve, grushteve të shtetit, eksodeve;

**4.1.4** aktet terroriste, trazirat, grevat, sabotimet.

**4.2** Dëmet në mjetin e siguruar, të bllokuar ose në tentativë bllokimi nga Organet e Shtetit.

- 4.3** Dëmet në mjetin e siguar kur mjete qarkullon pa e kryer Kontrollin teknik të detyruar apo kur nuk e ka kaluar atë.
- 4.4** Dëmet në mjetin e siguar kur mjete qarkullon ne vende të cilat nuk janë të përfshira në nenin 2 të ligjit **Nr.8378, datë 22.7.1998** Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë.
- 4.5** Dëmet e shkaktuara qëllimisht nga personi i siguar dhe/ose të udhëzuara nga personi i siguar.
- 4.6** Dëmet që shkatohen nga:
- 4.6.1** Në rastet kur pronari është person fizik (individ), përdorues, emrat e të cilëve nuk janë shënuar në Policën e Sigurimit, përveç bashkeshortit/bashkeshortes ose femijeve te pronarit te mjetit/te siguarit.
- 4.6.2** Në rastet kur pronari i mjetit, ose subjekti qe e ka marre mjetin me Kontrate Leasing, eshte person juridik:
- 4.6.2.1 Përdorues, të cilët nuk janë të punësuar nga personi juridik;
- 4.6.2.2 Përdorues të cilët janë të punësuar nga personi juridik, por nuk janë të pajisur me autorizimin përkatës të përdorimit të mjetit.
- 4.6.3** Në rastet kur pronari i mjetit, ose subjekti qe e ka marre mjetin me Kontrate Leasing, eshte person juridik me objekt veprimtarie qiradhenien e mjeteve motorrike:
- 4.6.3.1 përdorues të cilët nuk janë të punësuar nga personi juridik;
- 4.6.3.2 përdorues të cilët janë të punësuar nga personi juridik, por nuk janë të pajisur me autorizimin përkatës të përdorimit të mjetit;
- 4.6.3.3 Përdorues qe e kane marre mjetin me qira dhe nuk kanë një kontratë qeraje për përdorimin e mjetit.
- 4.6.4** konsumi normal, defektet apo avaritë e brendshme elektrike, mekanike gjatë ndezjes ose lëvizjes së mjetit;
- 4.6.5** prerja apo përdorimi i gomave jashtë kushteve të sigurisë për shkak të konsumit të tepërt (skopjimi i gomave), dhe dëmet që janë rrjedhojë direkte e tyre.
- 4.6.6** përdoruesit, të pa pajisur me dëshminë e aftësisë për drejtimin e mjetit, me dëshmi aftësie të pavlefshme, dhe/ose kur dëshmia e aftësisë është hequr me vendim të organeve kompetente. Do të konsiderohet dëshmi aftësie e pavlefshme edhe rasti kur dëshmisë së aftësisë i ka kaluar afati i përdorimit, sipas parashikimit të ligjit;
- 4.6.7** drejtuesi i mjetit kur ky ndodhet nën ndikimin e efekteve të alkoolit, substancave narkotike apo psikotrope, si dhe në rast se refuzon t'i nënshtrohet provave të këtij kontrolli;
- 4.6.8** dëmtimi i mjetit gjate lëvizjes në rrugë, kur vlera e dëmit kalon mbi 30% të vlerës së marrjes në sigurim nëse nuk ka proces verbal policie për ngjarjen aksidentale, si dhe vërtetim nga organet kompetente që mjete nuk është drejtuar nën ndikimin e alkoolit.
- 4.6.9** transportimi i lëndëve shpërthyesë të tilla si: radioaktive, eksplozive, gërryese, ndezëse, jonizuese, etj
- 4.7** Dëmet në mjetin motorrik të shkaktuara gjatë kryerjes së operacioneve të shërbimit, riparimit, kontrollit, larjes, dorëzimit ose shitjes, si dhe dëmet në dhe/ose gjate parkimit ne funksion te kryerjes se ketyre sherbimeve .
- 4.8** Dëmet ose humbjet e objekteve, sendeve personale, aksesorëve të mjetit me vlerë mbi 1% të shumës së sigurimit, mallrave, ose bagazheve që ndodhen në mjet në momentin e ndodhjes së rastit të sigurimit.
- 4.9** Nuk mbulohet zmadhimi i humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhencës/pakujdesisë të të Siguarit/personit të autorizuar/Qiramarresit ose mosmarrjes së masave parandaluese që të mos

thellohen ato. Nga ana tjetër Siguruesi do të paguajë shpenzimet e arsyeshme te cilat nuk lejojnë që të zmadhohen dëmet ose humbjet.

- 4.10** Siguruesi në asnjë rast nuk mbulon dhe nuk përgjigjet për fitimin e munguar
- 4.11** Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për demshpërblim ose të japë ndonjë përfitim sipas kësaj kontrate, nëse ofrimi i një mbulimi të tillë, pagesa e një kërkesë të tillë ose dhënia e një përfitimi të tillë do të ekspozonte Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi, sipas Rezolutës së Kombeve të Bashkuara ose sanksioneve tregtare ose ekonomike, ligjeve ose rregulloreve të Bashkimit Europian, gjithashtu sipas Ligjit Shqiptar, Mbretërisë së Bashkuar ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- 4.12** Pavarësisht dispozitave të përmbajtjes së ndryshme brenda këtij sigurimi ose çdo miratimi pranohet që ky sigurim përjashton humbjen, dëmtimin real dhe personal të pasurisë, kostot ose shpenzimet e çfarëdo natyre, të shkaktuara direkt ose indirekt të shkaktuara nga çdo sulm kibernetik, qe rrjedhin nga perdorimi si mjet per te shkaktuar dem i cdo kompjuteri, sistemi kompjuterik, programi soft kompjuterash, kode keqdashesh, virusesh kompjuterike ose cdo sistemi apo paisje tjeter elektronike.

## **Neni 5 DETYRIMET E TË SIGURUARIT**

I Siguruari është I detyruar të njoftojë siguruesin me shkrim jo më vonë se 5 ditë nga ndodhja e ngjarjeve të përshkruara më poshtë, në rast të kundërt humbet të drejtën për demshpërblim;

- ndryshim i emrit
- ndryshimi i qëllimit të përdorimit të automjetit
- lidhja e kontratës me sigurues të tjerë
- ndryshimi i pajisjeve kundra vjedhjes
- heqja e dëshmise së aftësisë së drejtimit
- vjedhja ose humbja e dokumentave të regjistrimit dhe celësave të automjetit

## **Neni 6 PERIUDHA E SIGURIMIT**

- 6.1** Periudha e sigurimit si rregull është jo më pak se një vit, përveç rasteve kur në Policën e Sigurimit përcaktohet ndryshe. Në rastet kur palët bien dakord që Polica e Sigurimit të lidhet për periudhë më të shkurtër se një vit, periudha e sigurimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një muaj.
- 6.2** Kontrata e sigurimit quhet e lidhur në momentin e nënshkrimit të kontrates së sigurimit nga palët. Në çdo rast mbulimi në sigurim do të krijojë efekte juridike për Siguruesin vetëm pasi të jetë paguar primi i sigurimit.
- 6.3** Kontrata e Sigurimit hyn në fuqi në orën 24:00 të datës së treguar në Kontraten e Sigurimit si datë fillimi, me kusht që të jetë paguar primi i sigurimit, nëse nuk është rënë dakort me shkrim ndryshe.
- 6.4** Nëqoftëse për ndonjë arsye primi i sigurimit nuk paguhet në afatin e kërkuar, hyrja në fuqi pezullohet deri në orën 24 të ditës që i siguruari paguan primin e sigurimit. Pezullimi nuk mund të bëhet për një periudhë më të gjatë se 30 ditë. Me kalimin e këtij afati kontrata quhet e zgjidhur automatikisht në mënyrë të njëanshme nga i Siguruari, i cili detyrohet t'i paguajë Siguruesit kostot/shpenzimet administrative.
- 6.5** Përgjegjësia e Siguruesit do të fillojë të krijojë efekte juridike në momentin kohor të përcaktuar në kontratë edhe nëse pagesa e primit të sigurimit mund të jetë kryer më parë.
- 6.6** Kontrata e Sigurimit përfundon në orën 24.00 të datës së mbarimit të caktuar në Kontratë.

## **Neni 7 SHTRIRJA TERRITORIALE**

- 7.1** Kontrata e Sigurimit, si rregull, vlen vetëm për dëmet që ndodhin në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 7.2** Zgjerimi i shtrirjes së territorit mund të bëhet me marrëveshje midis palëve, kundrejt pagesës së një primi shtesë. Në çdo rast që palët kanë rënë dakord për mbulim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, teritorret që është rënë dakord të mbulohen do të përcaktohen shprehimisht në Policë.
- 7.3** Kur në seksionin “Territori” të policës së sigurimit nuk ka territor të përcaktuar, do të nënkuptohet se territori i mbulimit është Republika e Shqipërisë.
- 7.4** Mbulimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të ofrohet vetëm në rastin kur kontrata e sigurimit lidhet për një periudhë një vjeçare.

## **Neni 8 POLICA E SIGURIMIT**

- 8.1** Polica e sigurimit është dokumenti i nënshkruar mes siguresit dhe të siguruarit, e cila dëshmon pranimin e kushteve të përgjithshme nga i siguruari dhe përfundimin e kontratës së sigurimit.
- 8.2** Polica e sigurimit lëshohet në bazë të “Pyetësorit Kasko”, i cili është një pyetsor standard i përgatitur nga siguresi dhe që plotësohet nga i Siguruari. Si perjashtim, në rastin e sigurimit të flotave ose mjeteve të shoqërive me numër të konsiderueshëm mjeteve, Polica e sigurimit lëshohet në bazë të "Kerkese per Marrje ne sigurim" ose sipas Marrëveshjes mes Siguresit e të Siguarit. Siguresi lëshon policën e sigurimit dhe llogarit primin e sigurimit bazuar në të dhënat dhe deklaratimet e bëra nga i siguruari në Pyetësorin Kasko/ Kerkesen per Marrje ne Sigurim/Marrëveshje.
- 8.3** I siguruari ose personi i autorizuar nga ai, nënshkruan pyetësorin kasko dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e deklaratimeve të bëra në të. Siguresi ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara nga i Siguruari dhe/ose të kryejë inspektimet e nevojshme. Në rast të zbulimit se Pyetëtori mban të dhëna të rreme ose të pavërteta, siguresi çlirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit.
- 8.4** Pas plotësimit të pyetësorit i siguruari nuk mund të kryejë ndryshime pa miratimin me shkrim të siguresit, pas njoftimit të bërë prej të siguruarit. Nëse i siguruari njofton siguresin për ndryshime policen kasko, siguresi ka të drejtë të aplikojë një prim shtesë, nëse i miraton ndryshimet, ose anulon kontratën e sigurimit në rast se e sheh të arsyeshme mosmiratimin e ndryshimeve.

## **Neni 9 TRANSFERIMI I PRONËSISË**

- 9.1** Në rastin e ndryshimit të pronësisë së mjetit, kontrata e sigurimit mbaron në momentin kur pronësia mbi mjetin kalon tek pronari i ri.
- 9.2** Pronari i vjetër, në bazë të një kërkesë të tij, ka të drejtë të marrë kthimin e primit për kohën e mbetur, nëse gjatë periudhës së sigurimit s’ka ndodhur asnjë rast sigurimi.
- 9.3** Në rast se i siguruari vdes, mbulimi për mjetin e siguruar do të vazhdojë të aplikohet për trashëgimtarët ligjorë ose përfaqësuesin ligjor tek i të cilët kalojnë të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë për përdorimin e mjetit, deri në fund të periudhës së sigurimit me kusht që keta të fundit të njoftojnë me shkrim siguresin për humbjen e jetes së të siguruarit brenda një periudhe 10 ditore, dhe të marrin miratimin prej Siguresit.

## **Neni 10 SHUMA E SIGURIMIT**

Shuma e sigurimit është vlera për të cilën është siguruar mjete motorik. Shuma e sigurimit vendoset në kontratën e sigurimit dhe përcaktohet:

- 10.1** Për mjetet e reja – në rastin e vënies së mjetit në qarkullim për herë të parë, shuma e sigurimit është vlera e blerjes së mjetit të ri sipas faturës tatimore së shitblerjes nga dyqane të autorizuar.
- 10.2** Për mjetet e përdorura - Shuma e sigurimit propozohet nga ana e te Siguararit. Siguruesi ka të drejtë që përpara se të përcaktojë shumën e sigurimit verifikon vlerën e propozuar në manualët referuese të vlerës së tregut të mjeteve motorike.
- 10.3** Siguruesi në cdo rast ka të drejtë të aplikojë klauzolën e nënsigurimit të parashikuar në nenin 16 më poshtë. Siguruesi nuk mban përgjegjësi nëse mjete është marrë në sigurim për një shumë sigurimi që nuk përkon me vlerën reale të mjetit në treg dhe në rast dëmi i jep të drejtën atij të aplikimit të koeficientit të nënsigurimit.

### **Neni 11 LIMITI I PËRGJEGJËSISË**

Limiti i përgjegjësisë së siguruesit nënkupton vlerën të cilën Siguruesi detyrohet t'i paguajë të siguararit apo përfituesit të caktuar në policë në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Limiti i përgjegjësisë kufizohet, sipas rastit, në dy mënyra si më poshtë vijon:

- 11.1** Në rastin e dëmtimeve të pjesëshme, Limiti kufizohet në vlerën e nevojshme për riparimin e mjetit të dëmtuar sipas vleresimit të eksperteve të Siguruesit, ose vlerën në Lekë, për të riparuar dëmin sipas vlerës së tregut në momentin e ndodhjes së dëmit.
- 11.2** Në rast të vërtetimit të ngjarjes së sigurimit palët bien dakort që siguruesi ka të drejtë të bëjë riparimin e dëmit në serviset e licencuara dhe që kontraktohen prej tij.
- 11.3** Me kërkesë të të siguararit për të marrë kundërvlerën në Lekë, nëse siguruesi bie dakort paguan shumën pasi përcakton vlerën e dëmit. Pasi i Siguarari vendos të pranojë shumën në Lekë për të riparuar dëmin, ai nuk ka të drejtë të pretendojë për kompensime të tjera, për riparimin e dëmit edhe në rastet kur provohet nga ekspertë të tjerë që vlera e dëmit është më e madhe.
- 11.4** Në rastin e vjedhjes, grabitjes apo dëmtimit tërësor të mjetit, në vlerën e mjetit të vjedhur, grabitur ose dëmtuar totalisht, sipas vlerës së tregut në momentin e ndodhjes së dëmit, por jo më shumë se shuma e siguarar

Në rastet e dëmtimit total apo në rastet kur vlera e riparimit është më e lartë se shuma e marrjes në sigurim, siguruesi do të paguajë shumën e sigurimit duke zbritur pjesën e zbritshme si dhe vlerën e mbetur të mjetit. Vlerësimi i pjesës së mbetur bëhet me metodën e vlerësimit të shitjes së mjetit në gjendjen pas aksidentit, por gjithsesi jo më pak se 15% e vlerës së mjetit. Siguruesi nuk është i detyruar të mbajë vlerën e pjesëve të mbetura të padëmtuara, përveç rasteve kur bihet dakord midis palëve.

### **Neni 12 PJESA E ZBRITSHME**

Për çdo rast sigurimi do të aplikohet pjesa e zbritshme e cila, është ajo pjesë e dëmit që përballohet nga vetë i Siguarari.

Për rastin e parë të dëmit

- Siguruesi do të zbresë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit në masën 10%, po jo më pak se 5.000 lek (më poshtë quajtur franshiza)
- Për rastet e tjera Siguruesi do të zbresë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesë të zbritshme të përshkallëzuar në përqindje, e cila shtohet me 10 përqind për rastin e dytë dhe me nga 5 përqind për rastet e tjera deri në maksimum prej 40%. Ndërkohë franshiza është e njëjtë me 5.000 lek për çdo rast.
- Në rastin e parë të vjedhjes pjesa zbritshme është 20% por jo më pak se 20.000 lek. Për rastet e tjera të vjedhjes pjesa e zbritshme shtohet me 5 përqind propozuar për çdo rast ndërkohe që franshiza ngelet e njëjtë.



- Në rast dëmi total të mjetit pjesa e zbrishme është më së paku 20% e përshkallzuar si më lart, në rast se dëmi total nuk është rast i parë. Do të konsiderohet dëm total nëse dëmi është mbi 70% e vlerës së mjetit.

### **Neni 13 PRIMI I SIGURIMIT**

- 13.1** Primi i sigurimit është vlera që i siguruari detyrohet t'i paguajë Siguruesit. Tarifa e tij caktohet nga Siguruesi në bazë të llogaritjeve të bëra në varësi të mbulimit të zgjedhur dhe vecorive të mjetit motorrik. Vlera e primit përcaktohet në policën e sigurimit.
- 13.2** Primi i sigurimit paguhet nga i Siguruari sipas afatit të përcaktuar në Kontratën e Sigurimit. Pagesa e primit kryhet pranë degës ose pikes së shitjes ku është lëshuar Kontrata e Sigurimit dhe quhet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë bankare të Siguruesit. Si rregull primi/kësti paguhet para datës dhe orës kur është përcaktuar hyrja në fuqi e kontratës së sigurimit.
- 13.3** Në rastin kur mjeti motorrik i siguruar pëson dëm total për rreziqe të papërfshira në sigurim, pas fillimit të detyrimit të siguruesit, apo në rast se dëmi total është dëmshpërblyer mbi bazën e sigurimit të Përgjegjësisë ndaj Palëve të Treta të shkaktuesit të dëmit, të Siguararit i kthehet shuma e primit për periudhën e mbetur që nga dita në të cilën Siguruesi merr një kërkesë me shkrim nga i Siguruari, vetëm në qoftë se gjatë periudhës së sigurimit nuk ka ndodhur ndonjë rast sigurimi.
- 13.4** Në rastin kur mjeti motorrik i siguruar dëmtohet totalisht nga rreziqet e përfshira në sigurim, pas fillimit të detyrimeve të Siguruesit, Siguruesit i përket e gjithë shuma e primit për periudhën siguruese të kontraktuar.
- 13.5** Në rastin kur i Siguruari kërkon të anullojë policën e sigurimit përpara përfundimit të periudhës së sigurimit, i kthehet pjesa e primit për periudhën e papërdorur të sigurimit, në qoftë se Siguruesi deri në atë moment nuk ka paguar dëmshpërblim mbi bazën e kësaj kontrate sigurimi.

### **Neni 14 SIGURIME TË TJERA**

- 14.1** Nëse mjeti është i siguruar me policë kasko edhe në kompani të tjera sigurimi, për mbulim të të njëjtave rreziqe, i siguruari ka detyrim që të njoftojë secilin sigurues për të gjitha sigurimet. Nëse i siguruari qëllimisht nuk kryen njoftimin e mësipërm Siguruesi çlirohet nga detyrimi për të paguar shumën e dëmshpërblimit, si dhe ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit dhe të mbajë vlerën e primit.
- 14.2** Kur vertetohet ngjarja e sigurimit, i Siguruari duhet të njoftojë të gjithë Siguruesit duke i treguar secilit emrat e siguruesve të tjerë. Vlera e dëmshpërblimit nga kontratat e sigurimit asnjëherë nuk do të jetë më e madhe se vlera e dëmit minus pjesën e zbritëshme. Kjo vlerë dëmshpërblimi do të ndahet proporcionalisht midis kompanive të sigurimit sipas shumave të siguruar.
- 14.3** Në rastin kur i Siguruari kryen më shumë se një sigurim me qëllim përfitimi të paligjshëm, kontrata e Sigurimit quhet e pavlefshme dhe Siguruesi ka të drejtë të mbajë të gjithë primin e sigurimit.
- 14.4** Në rast se i Siguruari nuk është konsideruar fajtor në një rast sigurimi, dhe përfiton dëmshpërblim nga një tjetër Sigurues për shkak të sigurimit të detyrueshëm TPL, Siguruesi nuk është përgjegjës, për të kompensuar dëmin në mjetin motorrik.

### **Neni 15 MBISIGURIMI**

Mjeti motorrik quhet i mbisiguarur në rastin kur shuma e sigurimit e kalon ndjeshëm vlerën e tregut të mjetit motorrik apo vlerën e blerjes së të njëjtit mjet motorrik të ri.

- 15.1** Në këtë rast palët mund të bien dakord për të zvogëluar shumën e sigurimit në nivelin e vlerës së mjetit motorrik dhe të zvogëlojnë proporcionalisht primin e sigurimit.
- 15.2** Në rast se i Siguruari e ka kryer këtë veprim me qëllim për të arritur përfitim prej tij, kontrata quhet e pavlefshme. Në këtë rast Siguruesi ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

**15.3**Nëse ndodh rasti i sigurimit (dëmtim total apo vjedhje e plotë), Siguruesi ka të drejtën e zëvendësimit të mjetit me një mjet tjetër të së njëjtës markë e model.

**15.4**Në cdo rast tjetër kufiri i përgjegjësisë së Siguruesit nuk do të jetë më i lartë se vlera e tregut apo vlera e blerjes së të njëjtit mjet motorik të ri, duke zbritur pjesën e zbritshme.

## **Neni 16 NËNSIGURIMI**

Mjeti motorik quhet i nënsiguruar në rastin kur shuma e sigurimit është më e vogël se vlera e mjetit në treg, apo vlera e blerjes së të njëjtit mjet motorik të ri .

**16.1**Palët mund të bien dakord për sigurimin e mjetit motorik me nënsigurim.

**16.2**Në cdo rast që me vullnetin e palëve ndodh nënsigurim, apo në rast se provohet nënsigurimi, në qoftë se ndodh ngjarja e sigurimit vlera e dëmshperblimit do të shumëzohet me koeficientin e nënsigurimit. Koeficienti i nënsigurimit është raporti i shumës së siguruar me vlerën e tregut të mjetit.

## **Neni 17 MASHTRIMI**

**17.1**Sigurimi nuk mund të jetë shkak përfitimi për të Siguruarin. Ai garanton vetëm riparimin e humbjeve reale ose të atyre për të cilat Siguruesi është përgjegjës.

**17.2**I Siguruari që në mënyrë të qëllimshme zmadhon shumën e dëmit, përdor me vetedije si justifikim mjete të mashtrimit, ose jep të dhëna apo paraqet dokumenta të paqëna apo jo reale gjatë plotesimit të dokumentacionit të marrjes në sigurim, apo kur ndodh dëmi humb të gjitha të drejtat e sigurimit për dëmin në fjalë.

## **Neni 18 NDËRPRERJA E KONTRATËS**

Kontrata mund të ndërpritet nga të dyja palët pas njoftimit me shkrim të tyre, duke njoftuar 30 ditë përpara

**18.1**Siguruesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën e sigurimit në qoftë se:

**18.1.1** I Siguruari nuk paguan këstin vijues të primit të sigurimit, ose primin e sigurimit për kontratat e rinovuara. Data e zgjidhjes do të jetë 15 ditë pas mbarimit të afatit të pagimit.

**18.1.2** I Siguruari ka dhënë informacione të pasakta.

**18.2** I Siguruari mund ta ndërpresë kontratën:

**18.2.1** Kur atij ose përdoruesit të mjetit motorik iu është hequr dëshmia e aftësisë.

**18.3**Në rastin e ndërprerjes së kontratës të Siguruarit do t'i kthehet pjesa e primit të sigurimit në porporcion me pjesën e mbetur të periudhës së sigurimit duke ju zbritur shpenzimet e marrjes në sigurim në masën 20%, te gjitha taksat, vetëm në rastin se Siguruesi deri në atë moment nuk ka paguar dëmshpërblim mbi bazën e kësaj kontrate sigurimi.

**18.4** Kontrata e sigurimit ndërpritet edhe në rastin kur mjeti çrregjistrohet tek organet kompetente me kthimin e targave dhe i Siguruari i ka njoftuar dhe paraqitur Siguruesit dokumentin i cili provon çrregjistrimin e mjetit. Në këtë rast, primi kthehet për periudhën e papërdorur të sigurimit duke ju zbritur shpenzimet e marrjes në sigurim në masën 20%, te gjitha taksat dhe vetëm në rast se Siguruesi deri në atë moment nuk ka paguar asnjë dëmshpërblim.

## **Neni 19 RINOVIMI**

**19.1**Në qoftë se Siguruesi, 15 ditë para mbarimit të periudhës së sigurimit, i ofron rinovimin e kontratës të Siguruarit ose personit të autorizuar dhe këta të fundit nuk pranojnë, kontrata mbaron automatikisht në fund të periudhës së sigurimit.

**19.2**Në qoftë se I Siguruari, pranon rinovimin e kontratës, rivlerësohet tarifa bazuar në historikun e dëmshpërblimeve

## **Neni 20 NJOFTIMI I RASTIT TË SIGURIMIT**

Në rastin e ndodhjes së një ngjarje sigurimi i Siguruari, përdoruesi emri i të cilit ndodhet në Kontratën e Sigurimit, ose përfaqësuesi ligjor i autorizuar shprehimisht për njoftimin, duhet detyrimisht:

### **20.1 Të njoftojë, duke specifikuar rrethanat e ngjarjes, menjëherë rastin e sigurimit sipas afateve të mëposhtëme:**

- 20.1.1** Brenda 48 orëve nga momenti i ndodhjes së aksidentit. Ky njoftim do të kryhet me shkrim pranë Degës së Siguruesit që ka lëshuar kontratën e sigurimit, ose pranë strukturës përgjegjëse për trajtimin e dëmit pranë Siguruesit, në numrin e telefonit +355 4 2203330 dhe/ose adresën e emailit [demet@vig.al](mailto:demet@vig.al).
- 20.1.2** Brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes apo konstatimit së ngjarjes në rastin e vjedhjes. Ky njoftim duhet të bëhet me shkrim pranë Organeve të Policisë si dhe prane strukturës përgjegjëse për trajtimin e dëmit pranë Siguruesit, në numrin e telefonit +355 4 2203330 dhe adresën e emailit [demet@vig.al](mailto:demet@vig.al).
- 20.1.3** Menjehere nga momenti i konstatimit te cdo humbje te celesit te mjetit motorik. Ky njoftim duhet te behet menjehere me shkrim prane organeve te policise dhe prane Siguruesit.
- 20.1.4** Brenda 24 orëve nga momenti ndodhjes dëmit në mjet në rastin e zjarrit, eksplozionit dhe rrufesë. Ky njoftim duhet të bëhet pranë Repartit zjarrfikës, Organeve te Policise dhe me shkrim Siguruesit. Siguruesit i vihet në dispozicion një kopje e denoncimit pranë repartit të zjarrfikësit dhe organeve te policise brenda 48 oreve nga marrja e tyre
- 20.1.5** Brenda 24 orëve nga momenti i ndodhjes apo konstatimit të dëmit në mjet në rastin e thyerjes se xhamave. Njoftimi do të kryhet me shkrim pranë Degës së Siguruesit që ka lëshuar kontratën e sigurimit, ose pranë strukturës përgjegjëse për trajtimin e dëmit pranë Siguruesit, në numrin e telefonit +355 4 2203330 dhe/ose adresën e emailit [demet@vig.al](mailto:demet@vig.al).
- 20.1.6** Të njoftojnë, menjëherë nga momenti i ndodhjes apo konstatimit te ngjarjes së sigurimit, në varësi të rastit të sigurimit, në organet e policisë rrugore, policisë së shtetit, prokurorisë apo repartit të zjarrfikëses. I siguruari duhet të vërë brenda 24 orëve një kopje të denoncimeve apo njoftimeve të bëra, sipas legjislacionit në fuqi, në strukturat e sipërpërmendura.
- 20.1.7** Të plotësojë me shkrim ose te dergoje te plotesuar ne adresen e emailit [demet@sivig.al](mailto:demet@sivig.al) formularin “Njoftim i Rastit te Sigurimit”.  
Jo më vonë se 2 dite pune, nga momenti ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, t’i paraqesë Siguruesit foto të vendit të ngjarjes së bashku me të gjithë të dhënat identifikuese të mjetit motorik, të dëmtuar apo të humbur, si dhe sqarime mbi rrethanat përkatëse të ndodhjes së aksidentit. Formulari “Njoftimi i rastit të Sigurimit”, i përgatitur më parë nga Siguruesi dhe vene ne dispozicion te Siguararit pas njoftimit te ngjarjes se sigurimit si me lart, duhet të plotësohet me besnikëri dhe brenda afatit, pa shtrembërime të fakteve të rastit të sigurimit nga I Siguruari. Në rast të kundërt, Siguruesi ka të drejtë të çlirohet nga detyrimet për pagesën e dëmit.
- 20.1.8** Të marrë masa, për aq sa është e mundur, të shmangë dhe minimizojë humbjet apo dëmtimet.

## **Neni 21 VLERËSIMI I DËMIT**

**21.1** Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit i Siguruari duhet t’i paraqesi me shkrim Siguruesit kërkesën për dëmshpërblim shoqeruar me dokumentat e nevojshme ne varesi te ngjarjes se sigurimit

brenda 15 diteve nga dita e ndodhjes se kesaj te fundit. Kerkesa per demshperblim mund te paraqitet pas apo sebashku me njoftimin e Siguruesit te formularit “Njoftimi i Rastit të Sigurimit”.

- 21.2** Siguruesi ka të drejtë të verifikojë rrethanat në të cilat ka ndodhur rasti i sigurimit si dhe të kryejë ekspertimet e nevojshme për të përcaktuar madhësinë e demit brenda 3 ditëve nga data e njoftimit të ngjarjes së sigurimit. Ndërsa Siguruesi përfundon ekspertimet e nevojshme, mjeti mbahet pa u riparuar nga i Siguruari gjatë një periudhe 5 ditore nga e nesërmja e ditës së plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për hapjen e praktikës së demit
- 21.3** Siguruesi nuk do të paguajë vlerën e dëmshperblimit në rastet kur:
- I siguruar nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht detyrimet e tij
  - I siguruari paraqet në mënyrë të rreme ose mashtruese, fakte dhe rrethana me qëllim përfitimin një dëmshperblimi të padrejte apo rrisin masën e dëmshperblimit.
- 21.4** Kërkesa për dëmshperblim i drejtohet Degës pranë të cilës i Siguruari ka lidhur kontratën e sigurimit, ose strukturës përgjegjëse për trajtimin e demit pranë Siguruesit, në numrin e telefonit +355 4 2203330 dhe/ose adresën e emailit [demet@vig.al](mailto:demet@vig.al). I sigurari është i detyruar të paraqesë të gjitha dokumentet e nevojshme që kanë lidhje me rastin e sigurimit.
- 21.5** Në rast shuma e akorduar do të jetë gjithmonë brenda limitit të përgjegjësisë, edhe kur vlerësimi i demit kalon limitin e përgjegjësisë..
- 21.6** Në rast mosmarrëveshje, por vetëm pasi Siguruesi ka ofruar vlerësimin e tij, të dy palët krijojnë një komision arbitrazhi të paanshëm me pjesëmarrjen e ekspertëve të secilës palë dhe të një eksperti të tretë nga lista e ekspertëve të miratuar nga AMF. Në rast se nuk bihet dakord me ekspertin e tretë, ky i fundit caktohet me short nga lista e ekspertëve të miratuar. Shorti realizohet nga Siguruesi në ambjentet e tij. Shpenzimet e këtij komisioni përcaktohen në momentin e krijimit të tij nga palët.

## **Neni 22 PAGESA E DËMIT**

Siguruesi do të paguajë të Siguarin apo Perfituesin për dëmet në mjetin motorik të siguruar deri në limitin e përgjegjësisë duke zbritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit. Siguruesi nuk do të paguajë dëme të cilat janë më të vogla apo të barabarta me vlerën e zbritshme në vlerë absolute e quajtur Franshizë.

- 22.1** Siguruesi në varësi të demit, përcakton formën e dëmshperblimit, si më poshtë:
- Riparimin e mjetit të dëmtuar në servis të riparimit të ofruar nga Siguruesi. Nëse mjeti është brenda garancisë së prodhuesit/koncesionarit, siguruesi merr përsipër riparimin e mjetit në servise të autorizuara nga prodhuesi/koncesionari.
  - Pagesën e vlerës së demit.

Dëmshperblimi do të jetë deri në vlerën e demit të ndodhur dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojë limitin maksimal të përgjegjësisë të përcaktuar në policën e sigurimit, pasi është zbritur pjesa e zbritshme e përcaktuar në policë.

**22.2** Siguruesi ka detyrim që të paguajë demin ose riparoje mjetin sipas pikes 21.1, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për demshperblim dhe dokumentacionit të kërkuar.

**22.3** Siguruesi i njofton të siguarit apo përfituesit vlerën e llogaritur të dëmshperblimit. I siguruari/perfituesi udhëzon Siguruesin për mënyrën e kryerjes e pagesës së shumës së dëmshperblimit. Në rast se i Siguruari nuk është dakord me dëmshperblimin e ofruar, duhet të paraqesë refuzimin me shkrim, jo më vonë se 15 ditë nga marrja e njoftimit nga Siguruesi.

**22.4** Siguruesi ka të drejtë të zgjasë afatin e pagesës:

- Përsa kohë i siguruari nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi
- Në qoftë se ka filluar hetim penal, në lidhje me ngjarjen e sigurimit, kundër të siguarit
- Për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të siguarit për të marrë dëmshperblim.

- 22.5I** Sigurari do të njoftojë brenda 15 ditëve nga ndodhja vjedhjes, në qoftë se mjete i vjedhur do të gjendet. Në rast se nuk është dhënë parapagimi, mjete motorik i gjetur do të vihet në dispozicion të Siguararit, ndërsa Siguruesi paguan dëmet që mund të ketë pësuar mjete dhe që janë të mbuluara në sigurim. Në rast se është bërë parapagimi nga Siguruesi, mjete motorik i gjetur duhet të vihet në dispozicion të siguruesit, ndërsa të Siguararit do t'i paguhet pjesa e papaguar deri në limitin e përgjegjësisë. I siguruari ka të drejtë të marrë mjetin vetëm pasi ka kthyer parapagimin e bërë nga Siguruesi, duke reduktuar nga kjo shumë pagesat për dëmet që mund të ketë pësuar mjete.
- 22.6K**thimi i shumës bëhet jo më vonë se 30 ditë nga gjetja e mjetit. Nëse i Siguarari nuk e kthen shumën e mësipërme, pronësia mbi mjetin i takon Siguruesit.
- 22.7P**jesa e papaguar deri në limitin e përgjegjësisë duke zbritur pjesën e zbritshme duhet paguar kur të gjitha procedurat investiguese janë mbyllur, por jo më vonë se 2 vjet.
- 22.8N**ë rast se është bërë dëmshpërblimi deri në limitin e përgjegjësisë dhe mjete gjendet, i Siguarari detyrohet të kthejë pagesën që i është bërë.
- 23.1N**ë rast se i Siguarari ka bërë deklaratë të rreme, është implikuar në veprime mashtrimi duke përvetësuar me të padrejtë një dëmshpërblim, Siguruesi ka të gjitha të drejtat e personit të dëmtuar kundër tij.
- 23.2S**iguruesi do të paguajë deri në 3,000 leke për shpenzimet e transportit të personave të demtuar deri në qendrën spitalore më të afërt.
- 23.3S**iguruesi paguan shpenzimet e ruajtjes së mjetit nga momenti i rastit të sigurimit deri në përfundim të ekspertizës së nevojshme, por jo më shumë se 1,000 lekë gjithsej.
- 23.4P**as likuidimit të cdo dëmshpërblimi mbi 50% të vlerës së mjetit, mjete motorik mbetet i siguruar deri në mbarim të afatit të kontratës së sigurimit për diferencë midis shumës së siguruar dhe dëmshpërblimit të paguar. Me kërkesën e të Siguararit, shuma e siguruar mund të rivendoset duke paguar prim shtesë sipas të njëjtit tarife të marrjes në sigurim. Te gjitha vlerat e dëmeve pas dëmit të parë do të shumëzohen me koeficientin që del nga raporti i shumës së mbetur të sigurimit me shumën e sigurimit të shënuar në policë, në rastin kur klienti nuk ka paguar prim shtesë për rivendosjen e saj.

## **Neni 24**

### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet midis Siguruesit dhe të Siguararit kur nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

## **Neni 25**

Për gjithçka që nuk është parashikuar në këto Kushte do të aplikohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil.

## **Neni 26 DISPOZITA TE VECANTA**

- 26.1A**fati maksimal për marrjen në sigurim të mjeteve motorike është vjetërsia e mjetit jo më shumë se 10 vjet nga viti i prodhimit. Nëse Siguruesi pranon sigurim për mjete më të vjetër se 10 vjet, sigurimi për këto mjete nuk mbulon rastin e vjedhjes. Gjithashtu, në rastin e ndodhjes së dëmit, qoftë ky total ose i pjesshëm, masa e dëmshpërblimit do të jetë deri në 50% të vlerës së dëmit të llogaritur.
- 26.2N**ë rastin e vdekjes aksidentale të shoferit të mjetit motorik, e shkaktuar kjo gjatë aksidentit automobilistik, mbulohen shpenzimet deri në shumën 200,000 lekë, përveç rasteve përjashtimore të parashikuara në nenin 4.
- Shoqëria e Sigurimit Sigma Inter Albanian VIG sh.a, në rastin e aksidenteve të mbulueshme, paguan shumën deri në 50,000 lekë për marrjen e një makine me qera, vetëm në rastin kur mjete motorik

është siguruar nga të gjitha rreziqet, koha e nevojshme për riparim është më shumë se dy jave dhe vlera e mjetit të marrë në sigurim është më shumë se 50,000 Euro.

**26.3** Në rastin e ngjarjeve të sigurimit sipas pikave 3.1, 3.5, 3.6, 3.8 të nenit 3, për të cilat Siguruesi ka demshperblyer të Siguruarin, para se të percaktohet fajësia në ngjarjen ku është përfshirë mjete I siguruar, Siguruesit i kalon nga I Siguruarit automatikisht me kryerjen e pageses së dëmit material, të gjitha të drejtat për demshperblim për dëmin material që I Siguruarit ka ndaj shkatërrimit të ngjarjes aksidentale, kur ky i fundit nuk është vetë i Siguruarit apo drejtuesi i mjetit të siguruar.